

Doracak për përdorimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e komunitetit LGBTI

DORACAK PËR PËRDORIMIN E MEKANIZMAVE INSTITUCIONALË PËR MBROJTJEN E KOMUNITETIT LGBTI

Shkup

2016

PËRMBAJTJA:

1.HYRJE 1

2.NJOHJA E DHUNËS, GJUHËS SË URREJTJES DHE DISKRIMINIMIT NDAJ KOMUNITETIT LGBTI 2

2.1 DHUNË NGA URREJTJA 2

2.2 GJUHA E URREJTJES 3

2.3 DISKRIMINIMI 5

2.4 DHUNË NË FAMILJE 7

3.MBROJTJE INSTITUCIONALE NGA DHUNA HOMOFOBIKE DHE TRANSFOBIKE, GJUHA E URREJTJES DHE DISKRIMINIMI 8

3.1 POLICIA 8

3.2 PROKURORI PUBLIK 10

3.3 SEKTORI PËR KONTROLL TË BRENDSHËM DHE STANDARDE PROFESIONALE 11

3.4 AVOKATI I POPULLIT 11

3.5 KOMISIONI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI 13

3.6 QENDRA PËR PUNË SOCIALE 14

3.7 NJËSITË RAJONALE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË. QASJE PËR NDIHMË FALAS 15

3.8 KOMISIONI PËR ANKESA NË KËSHILLIN E ETIKËS PËR MEDIUME 17

4.ORGANIZATAT QYTETARE 18

1. Hyrje

Objektiv i këtij doracaku është që në një vend t'ua sjell të gjitha informacionet e nevojshme për personat e LGBT, se si të njohin dhe denoncojnë dhunën dhe gjuhën e urrejtje të bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Pjesa e parë e doracakut i përkushtohet njohjes së diskriminimit, dhunës dhe gjuhës së urrejtjes të bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.

Pjesa e dytë e doracakut ka të bëjë me shpjegim më të hollësishëm të mekanizmave institucionale ekzistuese për mbrojtje nga komuniteti LGBT, në Republikën e Maqedonisë. Doracaku shpjegon edhe llojet e procedurave, të cilat do të mund të ngrihen para institucioneve të caktuara kombëtare për mbrojtje nga dhuna, gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin e komunitetit LGBT. Nëpërmjet shpjegimit dhe mënyrës së funksionit të këtyre mekanizmave kombëtar të cilët mund të përdoren për mbrojtje të komunitetit LGBT, përfshihet edhe korniza ligjore që trajton diskriminimin, dhunën dhe gjuhën e urrejtjes në Republikën e Maqedonisë.

Pjesa e fundit e doracakut jep informacione për organizatat qytetare, të cilat punojnë për drejtat e njeriut të komunitetit LGBT, dhe shërbimet të cilat i ofrojnë.

2.Njohja e dhunës dhe gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimi ndaj komunitetit LGBT

Njëri nga shkaqet e mosdenoncimit të dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminim ndaj homofobisë dhe transfobisë, është pamundësia që nuk arrijnë ta njohin ose ta zbulojnë. Personat LGBT, në Republikën e Maqedonisë çdo ditë ballafaqohen me stigmatizimin, patologjizimin, përqeshjen dhe diskriminimi. Gjendja shoqërore e një vazhdimësie të mospranimit dhe refuzimin e orientimit të ndryshëm seksual dhe identitetit gjinor, por edhe përkufizimin e tyre si "jo normal" dhe të padëshiruar, në të shumtën e rasteve rezultojnë me vetëfajësim, frikë nga dhuna, ngacmimi në shkolla, mospranimi nga familja merret si dukuri normale, madje edhe e merituar.

Për mosdenoncimin e veprave nga urrejtja ndaj personave LGBT dhe mosbesimi që pritet nga institucionet, të cilët kanë për detyrë t'i mbrojnë, mosekzistimi dhe /ose joefikasiteti i mekanizmave për mbrojtje nga dhuna, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminim ndaj homofobisë dhe transfobisë,

Njërën nga poentat kryesore të cilën duhet ta kemi ndërmend, është se me heshtjen e dhunës lejojmë, mundësojmë që ajo të na përsëritet neve dhe/ ose personave të tjerë LGBT. Me mosdenoncimin dhe mos njohjen e dhunës homofobe dhe transfobike lejomë që institucionet edhe më tej të vazhdojnë të injorojnë komunitetin LGBT dhe të ndërmarrin masat e duhura që të parandalojnë këtë. Dhe në fund, me denoncimin e dhunës, gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimin në mënyrën dhe ndihmën e duhur mundet vetëm t'i ndihmojmë vetvetes.

2.1. Dhunë nga urrejtja

Dhunë nga urrejtja nënkupton cilëndo vepër të dhunës të motivuar nga mostoleranca dhe paragjykimit ndaj ndonjë grupi të caktuar të shoqërisë, siç është në këtë rast komuniteti LGBT.

“Motiv i bazuar në paragjykime” do të thotë se autori zgjedh objektivin e veprës penale mbi bazë të karakteristikave mbrojtëse. Objektivi mund të jetë një person, më shumë persona ose pronë, e cila lidhet me ndonjë grupi të caktuar, pjesëtarët e të cilës ndajnë karakteristikë të caktuar mbrojtëse. Karakteristikë mbrojtëse paraqet karakteristika themelore ose qenësore, e cila identifikon grupin, si për shembull, racën, religjionin, etninë, gjuhën ose në rastin me komunitetin LGBT, siç është orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor.[1]

Sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë dhuna dhe urrejtja janë vepra ndëshkuese, përkatësisht gjatë caktimit të veprës ndëshkuese gjyqi ka parasysh se kjo vepër është motivuar nga urrejtja, mostoleranca dhe paragjykimi për një grup të caktuar.[2]

Përveç caktimit të dënimit Kodi Penal parasheh edhe veprat e veçanta penale, të cilat përfshijnë krim nga urrejtja sikurse në Nenin 137 ku parashihet dënim me burg të ndonjë karakteristike, sikurse është orientimi seksual dhe/ ose identiteti gjinor, që mund të marrë ose kufizojë të drejtat e njeriut të dikujt. Gjithashtu, Neni 319 parasheh dënim me burg prej një deri në pesë vjet, për atë i cili me detyrim, maltretim, cenimin e sigurisë, dëmtimin e sendeve ose ndonjë mënyrë tjetër të diskriminim do të shkaktojë urrejtje, përçarje dhe padurim ndaj një grupi të caktuar të shoqërisë, ndër të cilët edhe komuniteti LGBT.

2.2. Gjuha e urrejtjes

Gjuha e urrejtjes paraqet cilëndo gjuhë e cila përmban fyerje, poshtërime, sulme dhe /ose kërcënime ndaj individëve ose grupeve, për shkak të ndonjë karakteristike të tyre mbrojtjes sikurse është orientimi seksuale dhe identitetit gjinor. Te gjuha e urrejtjes objektivi është të poshtërohet,diskreditohet, të krijohen paragjykime, të nxitet diskriminim ose dhunë ndaj një grupi të caktuar siç është komuniteti LGBT. Që të mund të themi se ekziston gjuha e urrejtjes, do të thotë se duhet të plotësohen

1 TË KUPTUARIT E KRIMIT nga urrejtja. – Botim i publikuar. - Shkup: OSCE, 2014. – faqet 17, 15. ; 21 cm

2 Neni 39, paragrafi 5 i Kodit Penal

këto kushte. Kështu që, fyerjet dhe shpifjet e zakonshme[3] të cilat nuk kanë qëllim të lëndojnë për shkak të ndonjë karakteristikë mbrojtëse nuk paraqet gjuhë të urrejtjes.

Gjuha e urrejtjes paraqet dhunë verbale dhe psikologjike, e cila në të shumtën e rasteve sjell te dhuna fizike. Shembull për gjuhën e urrejtjes e cila sjell në dhunë janë sulmet LGBT Qendrës të Përkrahjes gjatë kohës së "Javës së Krenarisë" më vitin 2013. Pas një fushate intensive homofobe, e realizuar nga ministri i atëhershëm i punës dhe politikës sociale, Spiro Ristovski dhe propagandës homofobe në disa media kombëtare, LGBT Qendra e Përkrahjes dhe aktivistët përjetuan disa sulme fizike dhe tentativa për vënie zjarri.

Gjuha e urrejtjes përveç që sjell deri te dhuna, akoma më shumë fuqizon stereotipat, urrejtjen dhe djallëzimin e komunitetit të LGBT, me çka personave dhe aktivistëve LGBT iu pamundëson të krijojnë qëndrime pozitive të opinionit të përgjithshëm publik. Gjuha e urrejtjes është jashtëzakonisht e rrezikshme sidomos kur përdoret nga personat publik, në fjalimet e politikanëve dhe kjo praktikohet nga mediat.

Gjuha e urrejtjes ndër të tjera është rregulluar edhe në Kodin Penal dhe në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminim. Kodi Penal të Nenit 144 paragrafi 4 parasheh dënim me burg nga një deri më pesë vite, për atë i cili nëpërmjet sistemit të informatikës do të kërcënohet se do të kryejë vepër penale për të cilën parashihet dënim me burg prej pesë vitesh ose më të rëndë, kundër ndonjë personi për shkak të ndonjë karakteristikë të tij mbrojtëse sikurse është OSIGj (orientimi social dhe identitetin gjinor).

Shembull për këtë vepër janë kërcënimet për vdekje vetëm për faktin se dikush është homoseksual. Në Nenin 394-g të Kodit Penal parashihen dënim me burg nga një deri në pesë vjet burg për secilin që nëpërmjet sistemit kompjuterik shpërndan material, fotografi, ide ose teori e cila ndihmon në përhapjen e urrejtjes ndaj një grupi të caktuar. Me Nenin 417 " Diskriminimi racor dhe cilido diskriminim tjetër" është i ndaluar dhe

---

3 Fyerjet dhe shpifjet janë të rregulluara në Ligjin për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje, miratuar më vitin 2012

parasheh dënim me burg për shkelja të të drejtave dhe lirive themelore. Gjuha e urrejtjes në të shumtën e rasteve shkel të drejtën e sigurisë, ndonjëherë edhe të drejtën e privatësisë, por varësisht nga konteksti edhe të drejta të tjera.

Shpesh herë dëgjojmë se si dikush arsyeton gjuhën e urrejtjes me lirinë e shprehjes. Në këtë kontekst, duhet të dihet se lira e shprehjes ka kufi, dhe kufijtë vendosen atje ku fillon shkelja e dinjitetit, reputacionit dhe të drejtave të tjera të tjetrit. Në harmonizim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në shoqëritë demokratike e domosdoshme konsiderohet të sanksionohet, madje edhe të parandalohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose arsyetojnë urrejtjen e bazuar në mostolerancë.[4]

2.3. Diskriminimi

Në përputhje me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, diskriminim është çdo e drejtë e paarsyetuar ose faktike, duke bërë dallim ose veprim të pabarabartë, përkatësisht lëshim (përjashtim, kufizim ose dhënien përparësi) në raport me personat e tjerë të grupit, i cili bazohet sipas gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, seksit, përkatësisë së grupit të margjinalizuar, etnisë, gjuhës, shtetësisë, gjenezës sociale, religjionit dhe bindjeve fetare, arsimimit, bindjeve politike, statusi personal ose shoqëror, pengesa mendore ose fizike, mosha, gjendja martesore ose familjare, statusi i pronësisë, gjendja shëndetësore ose në çfarëdo lloj baze.

Edhe pse Ligji për parandalimin dhe mbrojtje nga diskriminimi në mënyrë taksative nuk e numëron orientimin seksual dhe identitetin gjinor si bazë për diskriminim, por megjithatë as nuk e përjashton. Orientimi seksuali dhe identitetit gjinor, hyjnë "në cilën do qoftë bazë", por gjithashtu diskriminimi ndaj komunitetit LGBT është paraparë në "përkatësinë e margjinalizuar[5]" ose "statusin personal dhe shtetëror". Mosekzistimi

4 Erbakan v. Turkey judgment of 6 July 2006, § 56

5 Grup i margjinalizuar paraqet grupi i individëve që i bashkon pozita specifike në shoqëri, të cilët janë objekt paragjykimesh, të cilët kanë karakteristika të veçanta të cilat i bëjnë të kapshme për lloje të ndryshme të dhunës, Nuk kanë shumë mundësi në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre,ose janë të ekspozuara në më shumë mundësi për viktimizim të mëtutjeshëm (definicion nga LPMD)

i numërimit të theksuar në Ligjin për orientim seksual dhe identitet gjinor, nuk është pengesë që t'i drejtohemi Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi. Gjithashtu, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi tashmë është në procedurë sipas parashtresave për diskriminim në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi ka miratuar Protokoll[6] për vërtetimin e procedurës për të vepruar në raste për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor është dokument intern i Komisionit, me të cilin, ndërmjet të tjerash do të vërtetoj vullnetin e tij që të verpoj në raste të diskriminimit në bazë të OSIGj dhe të mbrojë nga diskriminimi të personave LGBT.

Për njohjen të diskriminimit më e rëndësishme është të ekzistojë elementi i krahasimit, përkatësisht me ju të veprojnë ndryshe sepse jeni pjesë e komunitetit LGBT, kurse me të tjerët që nuk janë të veprojnë shumë më mirë.

Diskriminimi mund të jetë i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë. Për diskriminim të drejtpërdrejtë flasim kur haptas do t'ju ndalojnë të hynë në ndonjë klub ose kafene, sepse jeni homoseksual (gej burrë). Kurse diskriminim jo i drejtpërdrejtë ose indirekt, nënkuptohet kur kriteret për qasje për të gjithë janë të njëjtë, mirëpo në rezultate paraqitet diferencë e dukshme.

Gjithashtu, dikush mund të diskriminohet në më shumë baza, për shembull, sepse është homoseksual, sepse është rom, në këtë rast bëhet fjalë për më shumë lloje të diskriminimit.

Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, ngacmimin dhe qasjen poshtëruese njeh si cenim të dinjitetit ndaj personit të caktuar ose krijimin e ambientit të frikshëm, kërcënues, poshtërues dhe armiqësor, në qasje ose në praktikë.

Në të shumtën e rasteve ndodh që dikush të durojë pasoja të caktuara negative vetëm pse ka denoncuar diskriminimin. Për shembull, kur ju dëbojnë nga vendi i punës, sepse jeni ankuar se keni qenë të diskrimin-

6 Protokolli është në dispozicion në: https://zaokruzi20.wordpress.com/протокол/

uar. Kjo dukuri quhet viktimizim, dhe ndalohet gjithashtu në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminim.

Në përputhje me Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë diskriminimi është vepër penale. Kështu që, Neni 417 "Diskriminimi racor ose lloj tjetër i diskriminim" parasheh dënim me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet, për secilin që shkel të drejtat dhe liritë themelore, për shkak të ndonjë karakteristike mbrojtëse të dikujt, ndër të cilat edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor.[7]

2.4. Dhunë në familje

Dhuna në familje definohet si maltretim, ofendim, cenim të sigurisë, lëndim trupor, dhunë seksuale ose psikologjike, fizike ose ekonomike e cila shkakton pasigurinë, cenim ose frikë, për veprime duke përfshirë edhe kërcënime ndaj partnerit martesor, prindër dhe fëmijë, persona të cilët jetojnë bashkësi jashtëmartesore, ish partnerë martesor ose jashtëmartesor, pa dallim se a jetojnë në të njëjtën shtëpi.[8]
Dhuna familje është problem edhe i personave LGBT, sidomos për shkak të faktit se shumë rrallë vendosin t'iu drejtohen organeve kompetente për shkak të frikës se do të zbulohet orientimi i tyre seksual ose identiteti gjinor dhe vetëfajësimit. Shpesh ndodh që të rinjtë LGBT në fazë të zbulimit[9] para familjes së tyre të jenë viktima të dhunës e cila mund të ushtrohet nga prindërit ose anëtarët e tjerë të familjes. Në këto raste mundet dhe duhet të kërkohet mbrojtje nga institucionet kompetente, sepse definicioni i dhunës në familje, nënkupton dhunën ushtruar nga prindërit ndaj fëmijëve pa dallim se cilat janë arsyet për një sjellje të këtillë. Në rast të dhunës në familje ndihmë mund të kërkoni nga Qendra për punë sociale dhe nga policia. Gjithsesi, nëse bëhet fjalë për lëndime, ndihmë mund të kërkoni nga institucionet shëndetësor, kurse për ndihmë ligjore falas mund të drejtoheni në njësitë e Ministrisë së Drejtësisë.

---

7 Sikurse në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtje nga diskriminimi, OSIGj nuk theksohen veçmas, por parashihet përkatësia e komunitetit të margjinalizuar dhe statusi personal. Lista nuk është e mbyllur dhe parasheh cilëndo lloj baze të paraparë me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare. Nëpërmjet këtyre bazave mbrohet edhe komuniteti LGBT.

8 Neni 3, Ligji për prevenim, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje.

9 "Autimi" rrjedh nga fjala angleze "Coming out" dhe nocion që përdoret për momentin kur një person informon familjen e tij dhe / ose miqve se është gej/ lesbike/ transeksuale etj.

Dhuna në familje ekziston edhe në lidhjet homoseksuale, mirëpo shpesh për shkak të mosnjohjes të lidhjeve të tyre dhe bashkësive, personat LGBT konsiderojnë se nuk do të mbrohen nga dhuna në familje. Ligji për prevenim, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje, raportet e afërta personale i definojnë si marrëdhënie personale ndërmjet personave të cilët janë ose kanë qenë në lidhje të përbashkët partnere, pa saktësuar seksin-gjininë e personale. Nga veprimet e deritanishme të institucioneve nuk kemi praktikë të mbrojtjes së dhunës në familje në bashkësi joheteroseksluale, kështu që mbetet institucionet të testohen dhe të punohet në ndryshimin e ligjeve. Megjithatë, nuk ekziston pengesë ligjore që lidhjet homoseksuale të mbrohen nga dhuna në familje

3.Mbrojtje institucionale nga dhuna homofobike dhe transfobike, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi

Institucionet kanë mandat dhe detyrë të mbrojnë komunitetin LGBT nga dhuna, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi. Edhe pse shumë institucione nuk kanë shkathtësitë e duhura ose praktikë lidhur me mbrojtjen e komunitetit LGBT, domosdo të kujtojnë obligimet e tyre dhe të kërkohet prej tyre që t'i kryejnë obligimet e tyre.

Edhe pse ekziston një mosbesim i përgjithshëm ndaj institucioneve dhe vullnetit të tyre ose aftësi për të mbrojtur siç duhet komunitetin LGBT, megjithatë ka edhe praktika pozitive.

Në tekstin më tutje do të mësoni informacionet bazë të institucioneve, të cilat mund t'iu mbrojnë dhe për procedurat të cilat duhet t'i ndërmerrni. Theksi iu është vënë procedurave të cilat janë falas, më të thjeshta dhe për të cilat nuk nevojitet ndihmë e domosdoshme nga avokati.

3.1.Policia

Në polici mund të drejtoheni për gjithçka që paraqet shkelje dhe vepër penale në përputhje me Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë. Siç është përmendur më lartë, dhuna nga urrejtja, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi paraqesin vepra penale, të cilat duhet të denoncohen në po-

lici. Policia ka obligim ligjor të mbrojë jetën, sigurinë personale, pronën, të drejtat dhe liritë e njeriut.[10]

Policia ka obligim të mbroj identitetin tuaj (për shembull assesi nuk guxon të tregoj më gjerë, në rrethin ku jetojnë e më gjerë se jeni homoseksual) dhe në asnjë rast nuk guxon të sillet me poshtërim ose t'ju përqesh për shkak të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor, ose me vullnet të tyre të mos veprojnë, sepse konsiderojnë se nuk është serioze. Qëndrimet personale të punonjësve policisë në asnjë rast nuk guxojnë të ndikojnë në kryerjen e detyrave profesionale. Nëse kjo ndodh, atëherë mund të drejtoheni në Sektorin për kontroll të brendshëm dhe standardeve profesionale në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose tek Avokati i Popullit.

Secila nga veprat penale që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe dhunën nga urrejtja mund ta denonconi në cilindo stacion policor të Republikës së Maqedonisë ose punonjësit të policisë jashtë stacionit policor, zyrtari i policisë ka për obligim menjëherë të shkruaj procesverbal. Pas hartimit të procesverbalit, zyrtari i policisë ka obligim t'ua lexojë, dhe nëse keni vërejtje të njëjtat mund t'i evidentoni në procesverbal. Në rast se pajtoheni me procesverbalin, të njëjtin duhet ta firmosni. Me kërkesën tuaj, kur punonjësi policisë ka pranuar denoncimin (paraqitje) të procesverbalit (në stacionin policor)është i obliguar t'iu jep vërtetim për pranimin e denoncimit. Në rast se denonconi jashtë stacionit policor, punonjësi i policisë është i obliguar t'iu hartoj evidentim zyrtar me shkrim për pranimin e denoncimit për kryerjen e veprës penale.

Pas denoncimit të pranuar, punonjësi i policisë është i obliguar të ndërmarr masat dhe veprimet për vërtetimin dhe dokumentimin e veprës penale dhe e dorëzon te Prokurori Publik. Kallëzim penal mund të jetë kundër autorit të njohur ose të panjohur. Në këtë rast, ku punonjësi i policisë do të vlerësojë se është e domosdoshme të ndërmerren masa

10 Neni 5 Ligji për policinë – teksti i pastruar përfshinë: Ligjin për policinë (" Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 114/06), Ligji për plotësimin e Ligjit të policisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 6/09), Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të policisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/12), Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të policisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/14), Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të policisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 33/15) и Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë,("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 148/08)

dhe veprime të caktuar (dalje në vendndodhjes, sigurimi i vendndodhje, grumbullimi i të dhënave etj.), punonjësi i policisë do të hartojë kallëzim penal menjëherë pas ndërmarrjes së këtyre masave dhe veprimeve dhe do ta dorëzoj te prokurori publik.

3.2.Prokurori publik

Pasi që prokurori publik do të pranojë kallëzimin penal nga punonjësi i policisë, ai/ajo do të udhëheq me procedurën. Në Prokurorinë Publike do të mundet edhe vet të dorëzoni kallëzim penal, në këtë rast rekomandohet që të merrni këshillë juridike.

Obligimi bazë i prokurorit publik është që t'i ndjek autorët e veprave penale, dhe për këtë qëllim veprimet ia drejton policisë për zbulimin e autorëve dhe udhëheq gjatë gjithë procedurës.

Ky doracak për shkak të natyrës së ndërlikuar dhe të gjerë në procedurën penale nuk do të hyjë në përshkrimin e hollësishëm të ecurisë së procedurës penale, këtu do të ofrohen vetëm informacionet bazë.

E rëndësishme është të dihet se ekziston Prokuroria Themelore Publike e cila themelohet në zona të gjykatave themelore dhe Prokurorisë së Lartë Publike. Prokuroria Themelore Publike, është e obliguar t'ju informojë. Nëse nuk pajtohen me vendimin që do ta merrni nga Prokuroria Themelore Publike keni të drejtë të ankoheni në Prokurorinë e Lartë Publike.

Vet kallëzimi penal është i ndarë në disa faza: procedura paraprake ku bënë pjesë procedura para hetimit dhe gjatë hetimit; faza e akuzimit në të cilën bënë pjesë dorëzimi i aktakuzës; faza e debatit kryesor dhe aktgjykimi në të cilën në gjykatën themelore debatohet për veprën dhe shqiptohet aktgjykimi; dhe faza e instrumenteve juridike me të cilat mund të ankoheni për aktgjykimin.

3.3.Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale

Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale paraqet mekanizmin kontrollues të Ministrisë së Punëve të Brendshme mbi punën e policisë dhe ministrisë, me çka edhe kompetencat e Sektorit përfshijnë një sektor më të gjerë të masave dhe aktiviteteve, të cilat ndërmerre, me çka vërtetojnë veprimin joprofesional, joligjor dhe joetik të punësuarve të policisë. Qytetarët kanë të drejtë të dorëzojnë parashtresë në Sektor për mbrojtje dhe realizim të të drejtave të tyre edhe kur konsiderojnë se veprimi i punonjësit të policisë ka shkelur të drejtat dhe liritë e tyre. Dorëzimi i parashtresës është falas. Për kontrollin e kryer të raportimeve që jepen në parashtresë Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale në afat jo më gjatë se 30 ditë nga pranimi i parashtresës me shkrim, duhet të informoj për gjendjen e konstatuar dhe masat e ndërmarra.[11]

3.4. Avokati i Popullit

Avokati i Popullit është organ, mandati i të cilit është që t'i mbrojë të drejtat e qytetarëve, kur ato shkelen me akte, veprime dhe anashkalimin e veprimeve nga organet e administratës shtetërore dhe organeve të tjera që kanë autorizime publike.[12]

Përkatësisht, roli i Avokatit të Popullit është t'i mbrojë qytetarët kur të drejtat e tyre janë shkelur nga ndonjë organ shtetëror. Kështu që, tek Avokati i Popullit mund të ankoheni nëse nuk keni marrë trajtimin e duhur nga policia, institucioni shtetëror shëndetësor, ndonjë ministri, komunë, ku keni qenë të diskriminuar ose nuk keni realizuar ndonjë të drejtë në institucionet shtetërore. Përkatësisht, Avokatit të Popullit mund t'i drejtoheni për diskriminim, gjuhë të urrejtjes dhe dhunës nga urrejtja mbi bazë të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor, kur të njëjtat burojnë nga institucionet ose të punësuarit në to.

---

11 http://www.mvr.gov.mk/page/sektor-za-vnatreshna-kontrola

12 Çdo organ i pushtetit shtetëror, njësi të vetëqeverisjes lokale, institucionet publike, ndërmarrjet dhe sektorët e shërbimeve.

Selia e Avokatit të Popullit gjendet në Shkup, mirëpo ka edhe zyra regjionale në Tetovë, Kumanovë, Manastirë, Shtip dhe Kërçovë. Pa dallim të vendndodhjes të selisë ose zyrave rajonale, Avokati i Popullit punon në rastet për shkeljen e të drejtave të të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, pa dallim të vendbanimit.

Procedura para Avokatit të Popullit fillon me parashtresën me shkrim që mund ta dorëzoni, ose me gojë në hapësirat e ose Avokatit të Popullit (me çka hartohet procesverbal), por mundet edhe nëpërmjet telefonimit dhe postës elektronike.[13]

Procedura para Avokatit të Popullit është falas.

Nëse vendosni për parashtresë me shkrim, të njëjtën edhe pse nuk ka formë të caktuar, megjithatë duhet t'i përmbajë këto elemente: të dhënat tuaja (emrin dhe mbiemrin, adresë dhe telefoni për kontakt), të dhëna për organin të institucionit shtetërore kundër së cilës dorëzoni parashtresën, përshkrimin e problemit (kur, ku dhe si institucioni shtetëror iu ka shkelur të drejtat) dhe mundet në bashkëngjitje të dorëzoni edhe dokumente të cilat do të dëshmonin shkeljen (për shembull vendimin me të cilin ju merret ndonjë e drejtë). Në hapurat e Avokatit të Popullit do të gjeni formular për parashtresë të cilën mund ta plotësoni. Te Avokati i Popullit mund të dorëzoni parashtresë në afat prej një viti nga ngjarja ose vendimi i organit nga i cili ankoheni.

Pasi që Avokati i Popullit do të pranojë parashtresën, në afat prej 15 ditësh do t'ju informojë se a do të ngrejë procedurë ose jo. Avokati i Popullit ka të drejtë t'ju kontaktojë dhe nga ju të kërkojë që ta plotësoni me informacione shtesë parashtresën. Gjithashtu, shkresa para Avokatit të Popullit mund të dorëzojë edhe personi që nuk është i dëmtuar, por duhet pajtim, autorizim nga i dëmtuari. Kjo do të thotë se te Avokati i Popullit në emrin tuaj organizatat qytetare mund të parashtrojnë parashtresë.
Me rëndësi është të dini se Avokati i Popullit është i obliguar me ligj të respektojë privatësinë dhe fshehtësinë e të dhënave të cilat shkruhen në parashtresë.

---

13 Në këtë lidhje mund të informoheni për përmbajtjen parashtresës, dhe po të njëjtën mund ta dërgoni në internet faqen e Avokatit të Popullit http://ombudsman.mk/MK/podnesi_prestavka.aspx

Nëse Avokati i Popullit pas dorëzimit të parashtresës konstaton shkelje, ka të drejtë të: jep rekomandim, mendim dhe t'iu udhëzojë në mënyrën e shmangies së shkeljes; të propozojë sërish të ngihet procedurë për shmangien e shkeljes së drejtës; të ngrejë nismë për zbatimin e procedurës disiplinore kundër personit përgjegjës; ose nga prokurori publik të kërkojë ngritje të procedurës për shkak të konstatimit të përgjegjësisë penale.

Kontaktet:

Internet faqja: http://ombudsman.mk/
Posta elektornike: contact@ombudsman.mk
Telefoni i selisë: 02 3129 335
Adresa e selisë: Rr. "Maqedonia" (karshi shtëpisë përkujtimore të Nënë Terezës)

3.5.Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi

Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi me punë ka filluar që nga viti 2011 dhe është formuar në përputhje me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Komisioni në përputhje me ligjin është organ i pavarur, i përbërë nga shtatë anëtarë, të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Për dallim nga Avokati i Popullit, Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi ka vetëm një zyrë në Shkup, e cila pranon parashtresa për diskriminim nga i gjithë vendi.

Në Komisionin mund të drejtoheni, në rast të diskriminimit (drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë), ngacmim dhe nxitje të diskriminimit dhe viktimizimit. Për dallim nga Avokati i Popullit, në Komision mund të drejtoheni kur diskriminimi vjen nga personi fizik, persona juridik (kompani), organe të institucioneve shtetërore, komuna etj. Gjithashtu mund t'i drejtoheni Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi e cila mund të ndodh në të cilëndo fushë: marrëdhëniet e punës, arsimit, mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, mediave, gjyqësisë dhe administratës, qasje për të mirat dhe shërbimet etj.

Procedura para Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi fillon me parashtresë, të cilën mund ta dorëzoni me shkrim ose me gojë në procesverbal. Parashtresa nuk ka forma rigoroze të parashtrimit, por e njëjta duhet t'i përmbajë të dhanë tuaja dhe kontakt personin/organin që ka kryer diskriminim, përshkrim të ngjarjes dhe të shkeljes dhe sipas mundësisë të dorëzohen dëshmi me ndihmën e të cilave mund të konstatohet akti ose veprimi i diskriminimit. Në internet faqen ose hapësirat e Komisionit mund të gjeni formular për parashtresë.[14] . Parashtresën mund t'ia dorëzoni Komisioni më së voni tre muaj nga dita kur ka ndodhur shkelja dhe më së voni një vit pasi keni mësuar për aktin e diskriminimit.

Pasi që do ta dorëzoni parashtesën, Komisioni do t'iu përgjigjet për mendim në të cilin thuhet se a është konstatuar diskriminim ose ndonjë shkelje tjetër. Mendimi duhet të përmbaj edhe rekomandimin se si të shmanget shkelja, të cilën personi ose organi ka bërë diskriminimi është i obliguar ta realizojë në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së mendimit.

Kontaktet:

Internet faqja: http://kzd.mk/
Posta elektronike: contact@kzd.mk
Telefoni i selisë: 02 323 2242
Adresa e selisë:"Dimitar Vllahov" p.n., godina e RTVM-së, kati 20, 1000 Shkup

3.6. Qendra për Punë Sociale

Qendrat për punë sociale kanë më shumë role, mirëpo në tekstin më poshtë do të përshkruhet roli i tyre në mbrojtjen nga dhuna në familje.

Në Qendrën për Punë Sociale mund të drejtoheni në rast të dhunës në familje dhe e njëjta ka për detyrë menjëherë të fillojë me procedurën, më së voni në afat prej 24 orë është i obliguar të ndërmarr masa për mbro-

14 Në lidhjen që pason mund të gjeni formularin për parashtresën http://kzd.mk/mk/dokumenti Parashtresën mund ta dërgoni online në internet faqen e Komisionit në këtë lidhje:http://kzd.mk/mk/kontakt/online-prijava

jtje të viktimës. Qendra për Punë Sociale mund të ndërmarrë këto hapa për mbrojtje të viktimës: akomodimin në Qendrën për Persona- Viktima të Dhunës në Familje; trajtim i duhur shëndetësor; trajtim dhe integrim psikologjik-social;trajtim psikologjik- social në qendrat e kështilldhënies; ndihmë për arsimim të rregullt për fëmijë; ndihmë juridike dhe përfaqësim; dhe përforcim ekonomik të viktimës nëpërmjet përfshirjes aktive në tregun e punës.

Qendra për Punë Sociale pas konsultimit të viktimës do të përcaktojë cilat nga masat e mbrojtjes janë më të përshtatshme dhe do t'i zbatojë, me çka hartohet edhe plan për punë individuale. Për shkak të seriozitetit të dhunës së ushtruar, nëse duhet do të hartohet edhe plan i sigurisë për të ndihmuar viktimën nga dhuna.

Qendrat e punës sociale dhe njësitë lokale të qendrave të pranishme janë në të gjithë vendin. Në internet faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale mund t'i gjeni kontaktet e qendrave të punës sociale dhe njësitë e tyre lokale.[15]

Ekzistojnë edhe SOS linja telefonike kombëtare ku mund të denonconi dhunë dhe t'iu ndihmojnë në numrat: 15 700 и (02) 15 315

3.7.Njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë. Qasje për ndihmë juridike falas

Në njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë mund të drejtoheni nëse keni nevojë për ndihmë juridike mund të drejtoheni në rast se keni nevojë për ndihmë ligjore falas.

Ndihmën ligjore falas mund të merrni nëse plotësoni kushtet ligjore, dhe i përkisni njërën nga këto kategoritë: persona që shfrytëzojnë asistencën sociale; shfrytëzues të asistencës për invaliditet, të cilët nuk marrin të ar-

15 http://mtsp.gov.mk/ -> të drejta dhe shërbime -> mbrojtja sociale -> instituione -> "kontakti me qendrat e punës sociale "ose " kontakte me njësitë rajonale të qendrave sociale"
Lidhjet: http://mtsp.gov.mk/content/pdf/kontakti_centri.pdf ose http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/podracni.pdf

dhura të tjera si përfitime ose të ardhura nga patundshmëritë; shfrytëzuesit e pensioneve më të ulët të cilët jetojnë në bashkësi familjare, me dy ose më shumë anëtarë që kujdeset ai për to; familje me nëna që vetë kujdesen me një ose më shumë fëmijë të mitur, të cilët realizojnë të drejtën për shtesë për fëmijët; fëmijë në rrezik[16] ; fëmijë për të cilin ekziston dyshimi se ka kryer vepër penale ose shkelje.

Kërkesën për ndihmë ligjore falas e dorëzoni personalisht nëpërmjet postës deri te njësia lokale e Ministrisë së Drejtësisë. Me këtë kërkesë dorëzoni edhe deklaratë të firmosur nga ju dhe nga anëtarët e familjes suaj me të cilët bashkërisht i bartni harxhimet e jetesës, pronës së patundshme dhe të tundshme dhe leje për qasje të të dhënave për gjendjen tuaj të pronës. Nëse, i takoni kategorisë së viktimës së dhunës në familje, deklarata nuk ka nevojë të firmoset nga anëtarët e familjes dhe do të duhet ta dorëzoni personalisht. Gjithashtu, do të duhet të dorëzoni edhe vërtetim nga organi kompetent që dëshmon statusin tuaj, nëse i përkisni njërit nga grupet e lartpërmendura.

Njësia lokale e Ministrisë së Drejtësisë, më së voni në afat prej 12 ditësh do të kompletojë kërkesën dhe do ta dorëzojë në Ministrinë e Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë në afat prej 8 ditësh do të veprojë sipas kërkesës së dorëzuar, me çka do t'ju informojë me anë të vendimit që do të sjell.
Ekzistojnë edhe shoqata civile të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas. Në vend që të drejtoheni drejtpërdrejtë në Ministrinë e Drejtësisë, në fillim mund t'iu drejtoheni këtyre shoqatave civile. Kontaktet e shoqatave civile të cilat janë regjistruar për ndihmë juridike falas dhe më shumë informacione për realizimin e kësaj të drejte mund të merrni në internet faqen: http://pristapdopravda.mk/

---

16 fëmijë në rrezik është çdo fëmijë që ka mbushur 7, e nuk ka mbushur 18 vjeç, me pengesa fizike ose mendore, që nuk ka përkujdesje edukative dhe sociale, i cili është në ashtu që gjendje ku është vështirë ose e pamundur të realizohet funksioni edukativ i prindërit/ve ose kujdestarit/ve, i cili nuk është i përfshirë në sistemin edukativo- arsimor, është i detyruar të lyp, të endet ose të ushtroj prostitucion, i cili përdorë droga dhe substanca të tjera psikotropike ose alkool, dhe për shkak të këtyre gjendjeve është ose mund të ketë qasje në ligj si viktimë ose si dëshmitar i ndonjë akti, i cili me ligj parashihet si shkelje, pse veprim ose akt i cili në ligj parashihet si vepër penale. (Neni 19, Ligji i drejtësisë për fëmijë)

3.8. Komisioni për ankesa pranë Këshillit të Etikës në Media

Edhe një formë institucionale që të mbroheni nga gjuha e urrejtjes homofobike dhe transfobike në media është Komisioni për ankesa pranë Këshillit të Etikës në Media në Maqedoni. E rëndësishme është të dihet se lajmi që përmban gjuhë të urrejtjes nuk do të thotë se ka të bëjë personalisht me ju, por mund jetë në lajmë e cila në përgjithësi ofendon të gjithë komunitetin LGBT.

Ankesa në Komisioni për ankesa pranë Këshillit të Etikës në Media mund ta dorëzoni me shkrim drejtpërdrejtë në Komision, ose me anë të postës elektronike[17]. Ankesën mund ta parashtroni kundër medias së caktuar (të shkruar, televizion dhe/ ose internet media), e jo drejtpërdrejtë kundër gazetarit. Keni të drejtë të dorëzoni ankesë më së voni në afat prej një muaj nga publikimi i lajmit kontestues (tekst/ kontribut). Komisioni për Ankesa pranë Këshillit të Etikës në Media në afat për një muaj duhet të del me qëndrimin e saj lidhur me ankesën. Për secilën ankesë komisioni, sjell vendim , dhe në rast se kundër medias së cilës bëhet ankesa, media nuk është anëtare, në këtë rast Komisioni sjell mendim. Komisioni për ankesa pranë Këshillit të Etikës në Media nga media do të kërkojë- shkelësi ta publikojë vendimin në vend dhe mënyrë të caktuar nga Këshilli, kurse nga mediat të tjera do të kërkojë që ta publikojnë.

Kontaktet:

Internet faqja: http://www.semm.mk/
Posta elektronike: info@semm.mk
Telefon i selisë: 02 322 25 95
Adresa: bul. “Metropolit Teodosij Gllavinov” 54/2, 1000 Shkup

17 http://www.semm.mk/ -> Komisioni për Ankesa -> formular për ankesa

4. Organizatat qytetare

Për pyetje dhe shërbime lidhur me mbrojtjen nga dhuna, gjuhën e urrejtjes, diskriminimit dhe dhunës në familjes mund të drejtoheni te më shumë organizata qytetare të cilat mbrojnë drejtat e komunitetit LGBBT. Shumë nga organizatat qytetare ofrojnë ndihmë juridike falas, akomodim dhe këshillim, kështu që nuk do të jeni vetëm që të kaloni në të gjithë mekanizmin institucional, por do të merrni ndihmë dhe këshilla profesionale. Gjithashtu në shumë institucione mund të drejtohen vetë organizatat qytetare.

Disa organizata qytetare gjithashtu kanë praktikë në dokumentimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të komunitetit LGBT. Në këtë mënyrë edhe po nuk deshët të ndërmerrni veprime konkrete para institucioneve, rasti juaj nuk do të jetë tërësisht i heshtur.

Në organizatat qytetare mund të drejtoheni edhe për shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin seksual dhe të riprodhimit dhe përkrahje psikosociale.

Më vijim keni listën e organizatave të cilat i ofrojnë këto shërbime.

Koalicioni të Drejta dhe Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuara

- Këshilla dhe ndihmë juridike falas

Dokumentimi i rasteve të shkeljes së të drejtave të LGBT, të cilët përdorin drogë, punonjësit seksual dhe njerëzit që jetojnë me HIV.

- Këshillimi dhe përkrahje falas psiko-sociale

Shërbimet ofrohen për personat LGBT, të cilët përdorin drogë, punonjësit seksual dhe njerëzit që jetojnë me HIV.

Kontaktet:

Bul. "Kliment Ohridski" nr.66-1 / 3, 1000 Shkup
irena.cvetkovik@gmail.com
http://coalition.org.mk/
02 3214 269

LGBT Qendra për Përkrahje

- Këshilla ligjore dhe ndihmë falas
- Grupet për përkrahje të homoseksualëve burra, lesbike, transseksual, prindërit, miqtë dhe familjet e personave LGBT
- Fondi i brendshëm- ndihmë fillestare në situata që prekin anëtarët e komunitetit LGBT (nevojë për intervenim mjekësor, kujdes, trajtim si pasojë e dhunës në bazë të urrejtjes, nevoja për ndërhyrje ligjore, ndihmë dhe përfaqësim, dhe nevojën për ndërhyrje për strehimin).

Kontaktet:

Rr. "Naum Naumovski Borçe" nr. 83, 1000 Shkup
info@lgbti.mk
http://lgbti.mk/
02 3256 174
SOS: 24/7: 0800 66 66 6

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë

- Këshillim dhe ndihmë ligjore falas

Kontaktet:

Rr. "Naum Naumovski Borçe" 83, 1000 Shkup
helkom@mhc.org.mk
http://www.mhc.org.mk/
02 3119 073

H.E.R.A - Shoqata për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim

- Këshilla ligjore dhe ndihmë falas

Telefon: 02 / 3290-395
Personi kontaktues: Igor Jadrovski

- Këshillim vullnetar dhe konfidencial dhe testimin për HIV

Telefon 02 / 3290-395 lokal 106
Personi për kontakt: Svetlana Vojnovska

Qendrat e të Rinjve "Dua të di" në Vodno dhe Shuto Orizare ofrojnë këto shërbime falas:

- Kontrolle gjinekologjike dhe këshillim
- Kontrolle dermatologjike
- Testimi për HIV
- Këshillimi psikologjik dhe psiko-social
- Edukimi bashkëmoshatar / edukimi me pedagog
- Shpërndarja e prezervativëve dhe materialeve edukative
- Këshillimi për parandalimin e përdorimit të drogave
- Mjeku i përgjithshëm (i shkollës)
- Këshilltar juridik
- Shpërndarja e prezervativëve dhe materialeve edukative

Qendra Rinore " Dua të di" - Vodno
Telefon: 02 / 3176-950
Personi i kontaktit: Maria Dragojloviç

Qendra Rinore "Dua të di" - Shuto Orizari
Telefoni: 02 / 2651-955
Personi i kontaktit: Nikolina Nikolovska

Qendra e Parë Familjare
- mbështetje psiko-sociale dhe këshillim për familjet që janë në konfliktit, në të cilën në mënyrë akute ushtrohet dhunë ose në të kaluarën ka pasur dhunë në familje.
Telefoni: 02 / 3215-905
Personi i kontaktit: Maja Balshikjevska

Kontaktet:
Rr."Debarcë" nr. 56/4, 1000 Shkup
http://hera.org.mk/
hera@hera.org.mk

EGAL- Barazia për homoseksualëve dhe lesbikeve

- Linja e informimit për homoseksual - për parandalim nga HIV / AIDS dhe IST[18] (02 / 3220-851 çdo ditë nga ora 13:00 -21: 00)

- Këshillimi për para dhe pas testimit HIV (çdo ditë pune nga 15: 00-19: 00)

- Këshillim vullnetar dhe konfidencial dhe testimi për HIV (e hënë, e mërkurë dhe e premte nga ora 17:00 -20: 00)

- Konsultim falas dhe trajtimi psikoterapi me një psikolog / psikoterapist (martën dhe të enjten nga 15:00-19: 00, caktimin e datave dhe konsultimeve përmes telefonit 078 / 431-871 terminet e caktuar paraprakisht)

18 Infeksionet seksualisht të transmetuara.

- Konsultim dhe këshillim falas me një punonjës social (të mërkurën dhe të enjten nga ora 16:00 -20: 00, caktimin e datave dhe konsultimeve përmes telefonit 078 / 431-871 në terminet e caktuara paraprakisht)

- Shpërndarja e prezervativëve, lubrifikantë dhe materialeve edukative (çdo ditë pune nga 13: 00-21: 00)

- Këshillim vullnetar dhe konfidencial për HIV dhe hepatit C- në terren. Testimi dhe Këshillimi kryhen në furgon të përshtatur në terren nga këshilltari dhe laboranti nga Instituti i Shëndetit Publik (data dhe lokacion ndryshojnë në varësi të nevojave, për më shumë informacione shihni profilin e Linjës për informacion Gej.

Kontaktet:

http://egal.org.mk/
info@dzunicafestival.mk
Telefon: 02 3220 851

Së bashku më të fortë- Shoqata për të Mbështetur Personat që jetojnë me HIV

- Grupe përkrahje socio-terapeutike për njerëzit që jetojnë me HIV
- Testimi i lirë, vullnetar dhe konfidencial për HIV
- Mbështetje kolegëve për njerëzit që jetojnë me HIV

Kontaktet:

http://hera.org.mk/?page_id = 606
zaedno.posilni@hera.org.mk
02/ 3129 200 ; 076/ 350 340

HOPS Opsionet për jetë të shëndetshme Shkup

HOPS ofron shërbimet e mëposhtme për përdoruesit e drogës dhe punëtorëve të seksit:

- Këshilla ligjore dhe ndihmë falas
- Dokumentimi raste të shkeljes së të drejtave të përdoruesve të drogës dhe të punëtorëve të seksit
- Shiringë sterile falas për injektim- gjilpërat ose shiringat në të gjitha madhësive, pajisje për përgatitjen - kuker, pambuk,, aqua, faculetë alkooli.
- Shërbimet themelore mjekësore
- Prezervativ, lubrifikantë falas dhe informacione mbi se si për të mbrojtur veten nga HIV, sëmundje ngjitëse seksuale, Hepatitit B dhe C
- Pa pagesë, vullnetar dhe konfidencial testimi për HIV
- Ndihmë për marrjen e letërnjoftimit ose dokumente të tjera personale,
- Shërbimet e një gjinekolog, psikiatër, psikolog, edukator dhe punonjësi social

Shërbimet ofrohen në katër drop-në Qendrat HOPS

- Qendra (drop) te Mavrovsja, nga e hëna deri të premten, nga ora 13 në 18 tel. numër 02 / 3130-058;
- Qendra në Kapishtec, nga e hëna deri të premten, nga ora 9 deri në 17, tel. numër 02 / 3176-428;
- Qendra në Shuto Orizarë, nga e hëna deri të premten nga ora 10 deri 16 , tel. Numri 076 / 631-635;
- Kujdesi ditën Qendra për Risistemimin dhe Rehabilitimin e Përdoruesve të Drogës dhe Familjeve të Tyre, tel. nr. 02 / 5112-684.

- Qendër Ditore Mbështetje për Punëtorët Seksual, çdo ditë pune nga 13 deri 18 tel. numër 02 / 2630-499 dhe
- Terren (kontaktoni nga ekipi në terren 075 / 769-948)

Kontaktet:

http://hops.org.mk/
hops@hops.org.mk
02 3 246 205

Botimi: Koalicioni ”Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të margjinalizuara”

Autore: Dragana Drdnarevska

Përkthimi dhe përshtatja në shqip: Luljeta Ademi

Dizajni: Borjana Mojsovska

Shtypi: Koma

Kopje: 200

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

351.84-055.34(497.7)(036)
364-055.34(497.7)(036)
342.7-055.34(497.7)(036)

DRNDAREVSKA, Dragana
Doracak për përdorimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e komunitetit LGBT / [autore Dragana Drdnarevska]. - Shkup : Koalicioni Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të margjinalizuara, 2016. - 28 стр. ; 21 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-65660-1-2

а) Маргинализирани заедници - Човекови права и слободи - Социјална заштита - Македонија - Прирачници
COBISS.MK-ID 100515338

Ky Doracak është mundësuar me mbështetje të popullit amerikan, nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID) në kuadër të projektit të USAID-it për shoqëri civile. Përmbajtja e raportit është përgjegjësi e Koalicionit “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të margjinalizuara” dhe nuk paraqet qëndrimet e USAID-it, ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

www.prijavinasilstvo.mk